

VENDIM
Nr. 678, datë 15.10.2014

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT
PËR MASAT PËR NXITJEN E TË
NXËNIT, VIJUESHMËRISË DHE
PËRPARIMIT TË NXËNËSVE ROMË
DHE EGJIPTIANË TË SHKOLLËS 9-
VJEÇARE “NAIM FRASHËRI”, KORÇË,
PËR VITIN SHKOLLOR 2014-2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit të 315 (treqind e pesëmbëdhjetë) bursave/kuotave ushqimore për nxënësit romë dhe egjiptianë të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë, për vitin shkollor 2014-2015.

2. Vlera e bursës/kuotës ushqimore ditore është 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në ditë për nxënë, për mbulimin e kostos ushqimore. Vlera e bursës/kuotës ushqimore që do t’u ofrohet nxënësve në mjediset e shkollës në formën e shërbimit ushqimor ditor të pakeluar për çdo nxënë për 170 ditë mësimore jepet sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë, në fillim të vitit shkollor, duhet të dërgojë pranë njësisë bazë të qeverisjes vendore, bashkisë Korçë, listën emërore të nxënësve romë dhe egjiptianë, përfutues të bursës/kuotës ushqimore, të detajuar nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Një kopje e listës emërore të nxënësve të trajtuar me bursë/kuotë ushqimore i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

4. Fondet publike për mbulimin e shpenzimeve për bursat/kuotën ushqimore jepen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për bashkinë Korçë dhe administrohen nga kjo bashki.

5. Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë dhe drejtoria e shkollës “Naim Frashëri”, Korçë, organizojnë aktivitete ekstrakurrikulare, me qëllim nxitjen e të nxënit, vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve romë e egjiptianë të kësaj shkolle. Këto aktivitete organizohen në përputhje me udhëzimin nr. 21, datë 23.7.2010, “Për normat e punës mësimore - edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, të

ministrit përgjegjës për arsimin.

6. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në programin buxhetor të arsimit 9-vjeçar.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave, bashkia Korçë dhe Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Pasqyra nr. 1
(KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE (VITI
MËSIMOR 2014-2015))

Nr.	EMERTIMI	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar/ njësi	Vlera ditore/ në lekë
1	Bukë	gram	120	341.95	100	12.0
2	Makarona	gram	10.5	37.45	120	1.3
3	Oriz	gram	10.5	38.15	150	1.6
4	Sheqer	gram	14	54.95	100	1.4
5	Fasule	gram	10.5	32.55	150	1.6
6	Perime	gram	45.5	9.45	100	4.6
7	Fruta	gram	35	14.7	100	3.5
8	Vaj	gram	10.5	94.5	180	1.9
9	Gjalpë	gram	7	53.2	531	3.7
10	Mish	gram	31.5	45.5	750	23.6
11	Djathë	gram	8.75	14	400	3.5
12	Reçel	gram	7	32.55	250	1.8
13	Vezë	kokërr	0.35	14.7	12	4.2
14	Qumësht	gram	70	34.3	80	5.6
15	Patate	gram	70	59.5	40	2.8
16	Nënprodukte pule dhe mishi	gram	10.5	35	400	3.2
	Kuota ditore			912.45		76

Shënim. Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojë sipas mënyrave të ndryshme dhe çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e prokurimeve dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).